



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.39, datë 28.09.2007

**“PER NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 63, DATË  
08.11.2005, “PËR MIRATIMIN E KOMISIONIT TË STREHIMIT”**

Bazuar në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore neni 8, pika l/d, ligjin Nr.9232, dt.13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” dhe V.K.M. Nr.53, dt.28.01.2005 “Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm, afateve dhe procedurave për të përfituar strehim nga programet e banesave sociale me qera” në pikën 3 dhe 4, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I**

1. Pika e parë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.63, datë 08.11.2005, “Për miratimin e Komisionit të Strehimit”, ndryshohet si më poshtë vijon:

- a- Fjalët “-*Kryetar, Drejtori i Shërbimeve Njerëzore*”, zëvendësohen me “- *Kryetar, Drejtori i Strehimit Social*”.
- b- Në listën e anëtarëve të komisionit të Strehimit, shtohet si anëtar i 8-të (tetë) i këtij Komisioni, një përfaqësues i **Këshillit Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuar (K.K.P.A.K)**.

2. Pika e dytë ndryshohet si më poshtë vijon:

- a- Fjalët “.....*Drejtorja e Shërbimeve Njerëzore,.....*”, zëvendësohen me “.....*Drejtorja e Strehimit Social,.....*”.

3. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi, Drejtorja e Strehimit Social, Drejtorja Juridike, Njësia e Planit Rregullues, Drejtorja e Infrastrukturës, Drejtorja e Administrimit të Aseteve.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SOKOL DERVISHAJ**

**K R Y E T A R**